REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 0012124
Datë/Datum. 06.02.2024
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0012
Data e Vendimit: 06.02.2024

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit ekonomik (OE) "Beni Dona Plast" SH.P.K. kundër Vendimit për dhënie të një kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) në kazermat Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë, Istog, Ferizaj, Pomozotin, Gjakovë, Prizren" për nevoja të FSK-së, ndarë në 3 LOT-e. LOT 1. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) kazerma në Prishtinë. LOT 2. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) në kazermat Istog Gjakovë, Mitrovicë dhe Gjilan. LOT 3. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) kazerma në Ferizaj, Pomozotin dhe Prizren" me numër të prokurimit 217-23-5070-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – "MINISTRIA E MBROJTJES", Kryetari i Panelit Shqyrtues me 06/02/2024, mori këtë:

Vendim

1. Hedhet si e palejuar, ankesa e "Beni Dona Plast" SH.P.K me nr. të protokollit 2024/0012, e datës 05.01.2024, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit "Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) në kazermat Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë, Istog, Ferizaj, Pomozotin, Gjakovë, Prizren" për nevoja të FSK-së, ndarë në 3 LOT-e. LOT 1. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) kazerma në Prishtinë. LOT 2. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) në kazermat Istog Gjakovë, Mitrovicë dhe Gjilan. LOT 3. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) kazerma në Ferizaj, Pomozotin dhe Prizren" , me numër të prokurimit 217-23-5070-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – "MINISTRIA E MBROJTJES".

2. Nuk i lejohet, autoritetit kontraktues – "MINISTRIA E MBROJTJES" që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) në kazermat Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë, Istog, Ferizaj, Pomozotin, Gjakovë, Prizren" për nevoja të FSK-së, ndarë në 3 LOT-e. LOT 1. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) kazerma në Prishtinë. LOT 2. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) në kazermat Istog Gjakovë, Mitrovicë dhe Gjilan. LOT 3. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim)

kazerma në Ferizaj, Pomozotin dhe Prizren" , me numër të prokurimit 217-23-5070-2-1-1, përkitazi me këtë ankesë, sepse ka në proces të shqyrtimit 3/tri ankesa tjera të parashtrua kundër vendimit të AK precizuar si më sipër.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik e-prokurimi me datë 05.01.2024, tek rubrika e ankesave ka pranuar një ankesë nga OE "Beni Dona Plast" SH.P.K, për aktivitetin e prokurimit me "Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) në kazermat Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë, Istog, Ferizaj, Pomozotin, Gjakovë, Prizren" për nevoja të FSK-së, ndarë në 3 LOT-e. LOT 1. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) kazerma në Prishtinë. LOT 2. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) në kazermat Istog Gjakovë, Mitrovicë dhe Gjilan. LOT 3. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) kazerma në Ferizaj, Pomozotin dhe Prizren" me numër të prokurimit 217-23-5070-2-1-1, inicuar nga "MINISTRIA E MBROJTJES", në cilësinë e autoritetit kontraktues.

Zyra e pranimit të ankesave pas pranimit të ankesës, gjatë verifikimit nëse ankesa është dorëzuar sipas rregullave dhe dispozitave ligjore, ka konstatuar se ankuesi për ankesën në fjalë, nuk ka ofruar dëshminë e pagesës siç kërkohet me pikën 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së dhe nenin 69 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik.

Nisur nga fakti se ankuesi ka parashtrua dy ankesa për të njëjtin aktivitet, zyra për pranimin e ankesave me datën 09.01.2024 përmes email-it e ka njoftuar OE ankues se me dt. 04/01/2024 OSHP ka pranuar Ankesë nga ju për AP me titull {Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) në kazermat Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë, Istog, Ferizaj, Pomozotin, Gjakovë, Prizren" për nevoja të FSK-së, ndarë në 3 LOT-e. LOT 1. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) kazerma në Prishtinë. LOT 2. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) në kazermat Istog Gjakovë, Mitrovicë dhe Gjilan. LOT 3. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) kazerma në Ferizaj, Pomozotin dhe Prizren, për te cilën është bashkangjitur dëshmia e pagesës. Po ashtu me date 05/01/2024 OSHP ka pranuar edhe një Ankese për të njëjtin AP, të cilës i është bashkangjitur dëshmia e pagesës e njëjtë me atë të ankesës tjetër. Andaj ju lutem na informoni se a keni parashtruar njërën ankesë gabimisht apo si është situata. Luteni te ktheni përgjigje ne te kundërtën njëra Ankese nuk do te procedohet tutje. Për të cilën OE ankues ka njoftuar OSHP me datën 10.01.2024 se gabimisht ka ngarkuar dy ankesa për te njëjtin aktivitet për arsyeje se gjatë ngarkimit kemi hasur ne probleme teknike të platformës e-prokurimi, duke kërkuar nga OSHP qe fletëpagesa të procedohet për njërën ankesë për shkak se behet fjalë për të njëjtën.

Nga provat e prezantuara vlerësohet se ankesa e parashtruar nga OE "Beni Dona Plast" SH.P.K e datës 05.01.2024 (protokoll 0012/2024), për aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) në kazermat Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë, Istog, Ferizaj, Pomozotin, Gjakovë, Prizren" për nevoja të FSK-së, ndarë në 3 LOT-e. LOT 1. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) kazerma në Prishtinë. LOT 2. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) në kazermat Istog Gjakovë, Mitrovicë dhe Gjilan. LOT 3. Shërbimet me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) kazerma në Ferizaj, Pomozotin dhe Prizren" me numër të prokurimit 217-23-5070-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – "MINISTRIA E MBROJTJES", konsiderohet si e pa kompletuar, nuk ka deponuar tarifën e sigurimit të ankesës së tij siç kërkohet në piken 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së lidhur me nenin 118 të LPP-së.

Ankuesi OE ka paraqitur dy ankesa në OSHP me numër; 008/2024, me datën 4.01.2024 dhe ankesën me numër 0012/2024, me datën 5.01.2024,(për të nijetin aktivitet prokurimi), ndërsa e ka paguar vetëm njëherë, një tarife të sigurimit të ankesës me datën 4.01.2024 dhe të njëjtën ja ka bashkangjitur të dy ankesave.

Ankesa ne numër, 008/2024, me datën 4.01.2024, konsiderohet e kompletuar, me pagesën e tarifës se sigurimit te ankesës me datën 4.01.2024 ashtu siç kërkohet në piken 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së lidhur me nenin 118 të LPP-së, dhe do te procedohet për shqyrtim të rregullt pranë këtij organi administrativ.

Derisa procedura e shqyrtimit të ankesës nr; 0012/2024, e datës 5.01.2024, përfundon në ketë fazë duke e hedhur të njëjtën si palejuar - jo e plotë ngase kjo ankesë nuk plotëson kushtet për tu proceduar më tutje siç kërkohet dispozitat ligjore të lartcekura.

Kryetari i Panelit shqyrtues, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Isa Hasani

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **MINISTRIA E MBROJTJES**
- OE - **Beni Dona Plast SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: